

7 mars 2022



Banka e Shqipërisë
Departamenti i Politikës Monetare




Komisioni Evropian¹

Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe të Konsumatorit

Treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE) regjistroi rënie të lehtë për të dytin muaj radhazi në shkurt. Niveli aktual i tij, 105.2, vijon të qëndrojë mbi mesataren afatgjatë (Grafik 1). Pakësimi me 1.9 pikë në shkurt u shkaktua nga rënia e besimit në pothuaj të gjithë sektorët e ekonomisë. Besimi në sektorin e industrisë mbeti në nivele të ngjashme me atë të një muaji më parë (Grafik 2).

Grafik 1. Treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE)




Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

Treguesi i besimit të industrisë (TBI) regjistroi nivel të ngjashëm me atë të një muaji më parë në shkurt (-0.1 pikë përqindje). Kjo reflektoi ndryshime me kahe të ndryshme të komponentëve përbërës të TBI-së. Vlerësimet më pesimiste të bizneseve lidhur me *kërkesën e brendshme* dhe *prodhimin industrial* u kompensuan nga vlerësimet më optimiste lidhur me *kërkesën nga eksportet*. Pritjet e bizneseve të industrisë për *prodhimin*, *punësimin* dhe për *çmimet* në të ardhmen janë në rënie në muajin shkurt (Tabelë 2, sektori i industrisë).

¹ Vrojtmet e besimit bashkë-financohen nga Bashkimi Evropian dhe Banka e Shqipërisë. Duke filluar nga muaji maj i vitit 2016, ato kaluan në programin e harmonizimit të Komisionit Evropian. Prej muajit qershor 2021 publikimi i analizave dhe të dhënave nga vrojtmet e publikohen me frekuencë mujore.

Treguesi i besimit në ndërtim (TBN) u ul me 3.9 pikë përqindje në shkurt, por duke mbetur në nivel të lartë, mbi mesataren historike (Grafik 1). Bizneset në ndërtim vlerësuan me rënie *aktivitetin ndërtues* dhe nivelin e *kontratave porositëse* në muajin shkurt. Pritjet e tyre për nivelin e *punësimit* ishin gjithashtu në rënie. Pritjet për *çmimet* e tyre në të ardhmen u rritën në muajin shkurt (Tabelë 2, sektori i ndërtimit).

Grafik 2. Treguesit e besimit sipas sektorëve*



Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.


Shënim: *Grafiku paraqet vlera të standardizuara, për të korrigjuar ndryshimet ndërmjet mesatareve dhe devijimeve standarde të treguesve të besimit përkatës.

Treguesi i besimit në shërbime (TBSH) shënoi rënie krahasuar me muajin e kaluar. Rënia e tij me 2.2 pikë përqindje në muajin shkurt u ndikua kryesisht nga vlerësime më pak pozitive për *kërkesën* për shërbime. Vlerësimet për *ecurinë e biznesit* kanë mbetur pothuaj të pandryshuara në krahasim me muajin janar. Pritjet e bizneseve të shërbimeve për nivelin e *punësimit* dhe të *çmimeve* të tyre në të ardhmen janë në rritje edhe këtë muaj (Tabelë 2, sektori i shërbimeve).

Treguesi i besimit në tregti (TBT) shënoi rënie me 4.8 pikë përqindje në muajin shkurt, i ndikuar kryesisht nga vlerësimet më pesimiste të bizneseve të tregtisë për *ecurinë aktuale të biznesit* të tyre (Tabelë 2, sektori i tregtisë). Pritjet e tyre për *kërkesën* dhe *ecurinë e biznesit* në muajt e ardhshëm janë vlerësuar gjithashtu në rënie, por në një masë më të vogël se vlerësimi për situatën aktuale. Pritjet për *çmimet* që do të vendosin në të ardhmen janë vlerësuar me rritje këtë muaj nga bizneset e tregtisë.


Treguesi i besimit konsumator (TBK) shënoi rënie të lehtë me 0.7 pikë përqindje në muajin shkurt, duke u pozicionuar më poshtë mesatares historike (Grafik 2). Kjo rënie reflektoi vlerësimin më pesimist të konsumatorëve lidhur me *blerjet në shumë të mëdha*, si dhe pritjet për *situatën e tyre financiare* dhe për *situatën e përgjithshme ekonomike* në vend (Tabelë 2, konsumatorët).

Grafik 3. Situata e biznesit sipas sektorëve gjatë muajve të fundit




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 4. Pritjet për situatën e biznesit gjatë muajve të ardhshëm




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 5. Pritjet për papunësinë dhe çmimet e konsumatorëve për 12 muajt e ardhshëm



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 6. Blerjet në shumë të mëdha të konsumatorëve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 1. Treguesit e besimit sipas sektorëve*

	Vlerat			2021				2022		Situata aktuale	
	min	mes	max	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Janar	Shkurt	Koniunkturale**	Strukture***
Industri	-60	-12.2	7.8	-7.4	-1.6	-4.5	-3.1	-6.9	-7.0	↓	+
Ndërtim	-57.4	-28.1	-7.9	-17.9	-13.8	-7.9	-18.8	-16.1	-20.0	↓	+
Shërbime	-46.7	5.1	27.2	17.7	22.5	22.8	27.1	23.0	20.8	↓	+
Tregti	-33.3	-2.5	18.4	6.4	5.9	5.4	8.2	11.7	7.0	↓	+
Konsumator	-40.8	-25.3	-16.5	-25.1	-32.6	-31.7	-29.8	-30.5	-31.1	↓	--

Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

*) Treguesit janë llogaritur nga balanca të rregulluara për sezonalitet. Balancat minimale, mesatare dhe maksimale, janë të llogaritura duke filluar nga muaji maj 2016.

**) Situata krahasuar me muajin e mëparshëm.

***) Situata për secilin tregues konsiderohet: shumë e kënaqshme (++), kur treguesi është më shumë se 1 devijim standard më i lartë se mesatarja; e kënaqshme (+), kur treguesi është më pak se 1 devijim standard më i lartë se mesatarja; e pakënaqshme (-), kur treguesi është më pak se 1 devijim standard më i ulët se mesatarja; dhe shumë e pakënaqshme (--), kur treguesi është më shumë se 1 devijim standard më i ulët se mesatarja.

Tabelë 2. Balancat kryesore të sektorëve të ekonomisë (në pikë përqindje)

	2021							2022	
	Qersh.	Korr	Gusht	Shtat	Tetor	Nëntor	Dhjet.	Janar	Shkurt
INDUSTRIA									
Prodhimi gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBI-së)	14.2	23.2	23.3	17.0	23.4	17.4	22.0	20.9	19.9
Kontratat porositëse (pyetja 2, komponent i TBI-së)	-18.7	-18.6	-17.6	-17.8	-11.1	-14.6	-11.7	-12.9	-21.1
Kontratat porositëse nga eksportet (pyetja 3, komponent i TBI-së)	-32.9	-26.8	-29.1	-21.3	-17.2	-16.2	-19.7	-28.5	-19.8
Inventari i produkteve të përfunduara (pyetja 4)	-3.4	-5.2	-5.9	-5.0	-6.0	-7.3	-3.6	-1.0	1.0
Prodhimi pritje (pyetja 5)	32.2	37.3	33.0	36.2	34.3	37.2	33.1	34.5	31.3
Çmimet e produkteve pritje (pyetja 6)	11.5	17.4	13.3	21.3	36.0	38.1	37.7	41.2	39.4
Punësimi pritje (pyetja 7)	9.2	17.3	5.8	11.6	10.8	13.3	19.4	21.7	16.1
NDËRTIMI									
Aktiviteti ndërtues gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBN-së)	7.2	15.2	10.8	3.6	5.5	6.7	-1.5	1.2	-3.3
Kontratat porositëse (pyetja 3, komponent i TBN-së)	-41.1	-37.9	-33.1	-39.3	-33.2	-22.4	-36.1	-33.5	-36.7
Punësimi pritje (pyetja 4)	14.6	14.9	12.2	10.8	7.6	9.7	6.1	15.9	0.8
Çmimet pritje (pyetja 5)	10.6	9.3	14.0	18.5	22.2	29.8	23.3	18.1	28.9
SHËRBIME									
Ecuria e biznesit gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBSH-së)	14.3	21.8	20.4	16.3	23.0	20.1	25.4	20.5	20.1
Kërkesa gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 2, komponent i TBSH-së)	12.2	21.4	23.5	19.1	22.0	25.6	28.8	25.4	21.4
Kërkesa pritje (pyetja 3)	34.3	37.9	36.7	22.7	12.6	30.5	36.5	32.3	30.2
Punësimi gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 4)	1.3	18.6	13.9	5.5	9.2	12.0	18.0	-5.5	14.0
Punësimi pritje (pyetja 5)	13.6	17.0	20.8	9.3	0.6	12.8	6.9	13.8	18.3
Çmimet pritje (pyetja 6)	9.3	10.3	4.3	8.1	29.9	22.5	21.7	23.8	30.0
TREGTIA									
Ecuria e biznesit gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBT-së)	19.7	32.0	10.0	11.5	9.7	9.7	10.8	20.5	10.4
Gjendja e inventarëve (pyetja 2)	2.3	-1.2	-0.7	0.1	0.9	0.4	0.0	-1.3	-1.7
Pritje për porositë në të ardhmen (pyetja 3)	29.8	30.5	27.7	21.2	24.2	25.0	36.1	29.9	26.7
Ecuria e biznesit pritje (pyetja 4)	32.9	34.7	32.6	25.3	31.6	30.1	37.9	30.4	28.7
Pritje për ecurinë e punësimit (pyetja 5, komponent i TBT-së)	5.4	4.9	2.5	1.4	2.1	1.1	5.6	3.0	3.5
Pritje për ecurinë e çmimeve (pyetja 6)	7.0	8.7	16.1	12.2	27.1	43.8	35.9	27.8	41.5
KONSUMATORI									
Situata financiare aktuale (pyetja 1)	-11.9	-11.1	-10.5	-6.8	-13.3	-13.9	-12.3	-12.5	-12.8

Situata financiare pritje (pyetja 2, komponent i TBK-së)	4.0	3.2	3.2	8.2	-3.8	-2.6	-0.9	-1.0	-1.8
Situata ekonomike aktuale (pyetja 3)	-20.5	-20.9	-19.1	-18.2	-22.8	-25.9	-23.6	-23.2	-22.5
Situata ekonomike pritje (pyetja 4, komponent i TBK-së)	3.9	1.7	2.6	2.0	-10.5	-5.8	-4.5	-3.3	-3.7
Çmimet aktuale (pyetja 5)	-1.8	2.5	-1.7	0.6	27.1	30.5	28.2	25.6	23.6
Çmimet pritje (pyetja 6)	-18.9	-11.4	-11.0	-7.6	8.1	-1.3	-4.6	-7.7	-7.5
Papunësia pritje (pyetja 7)	7.1	9.0	9.9	7.2	12.6	10.6	11.2	8.4	8.4
Blerjet e mëdha aktuale (pyetja 8, komponent i TBK-së)	-64.8	-63.4	-62.2	-62.6	-65.0	-66.3	-64.7	-68.8	-68.9
Blerjet e mëdha pritje (pyetja 9, komponent i TBK-së)	-49.6	-49.1	-48.4	-47.9	-51.0	-52.2	-49.1	-48.8	-50.2
Kursimi aktual (pyetja 10)	-46.2	-46.0	-41.9	-44.9	-48.6	-52.4	-47.2	-41.8	-45.1
Kursimi pritje (pyetja 11)	-44.7	-45.3	-40.5	-43.0	-48.7	-48.5	-45.6	-44.4	-44.8
Situata e të ardhurave dhe shpenzimeve (pyetja 12)	2.4	2.2	5.0	3.5	-1.3	0.6	0.2	1.5	0.8

Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

Aneks

Shpjegime metodologjike

Balanca është treguesi që përdoret më shpesh për agregimin e të dhënave cilësore nga vrojtimitet. Ajo llogaritet si diferencë midis përqindjes së përgjigjeve pozitive dhe përqindjes së përgjigjeve negative. Balanca shprehet në pikë përqindje.

Treguesi i Besimit (TB) ndërtohet për çdo sektor dhe llogaritet si mesatare e thjeshtë e balancave të rregulluara sezonalisht të treguesve të cilët kanë korrelacionin më të lartë me serinë e referencës (serinë e të dhënave reale të ekonomisë).

Treguesi i Ndjesisë Ekonomike (TNE) ndërtohet duke u bazuar në të njëjtat balanca që përdoren për ndërtimin e TB-ve për secilin sektor (industri, ndërtim, shërbime, tregti dhe konsumatorë), duke synuar të kapë aktivitetin e ekonomisë në vend. Para agregimit të TNE-së, këto balanca standardizohen dhe peshohen.